



Vrasja në Ferizaj, suspendohet nga puna për tri ditë edhe shefi i ndërrimit në Policinë e Ferizajt



17/08/2024 15:57



Një 89-vjeçar ka mbetur i vrarë të premten në fshatin Bibaj të Ferizaj, vrasja dyshohet se është kryer nga një polic, i cili tashmë është arrestuar edhe suspenduar nga puna.

Nga puna është suspenduar edhe shefi i ndërrimit në stacionin policor në Ferizaj për shkak të mos menaxhimit të mirë të policëve.

Kështu ka konfirmuar për Lajmi.net, zëvendës drejtori rajonal i Policisë në Ferizaj, Qazim Reka.

“Po shefi ndërrimit që ka qenë në atë kohë është suspendu”, ka thënë Reka.


Ndryshe, ngjarja e rëndë ka ndodhur të premten në fshatin Bibaj të Ferizajt, një person u vra në parkingun e sallës e dasmave “Fron Palace”.

Viktima S.S i moshës 89-vjeçar dyshohet se u vra nga një zyrtar policor, vrasja dyshohet se është kryer me armë zytare, ndërsa i dyshuari ishte jashtë orarit të punës.


Lidhur me rastin kanë reaguar edhe nga Inspektorati Policor i Kosovës, të cilët konfirmuan se i polici i dyshuar për vrasje është dorëzuar. /Lajmi.net/

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LuponMedia



Artikuj të ngjashëm



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyra nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information